

2020

Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

SARANDË



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Sarandë

VITI 2020

Ky raport është hartuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH), në kuadrin e projektit *“Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit”*. Projekti zbatohet në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara *“Për t’i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave”*, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe që po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë

Përmbajtja e këtij manuali është vetëm përgjegjësi e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim, dhe nuk reflekton opinionin e SIDA,UNDP, UNFPA dhe UN Women.

Tabela e Permbajtjes

TABELA E PERMBAJTJES	3
SHKURTIME	4
MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	7
GJETJET KRYESORE	8
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË SARANDË	9
TË DHËNA NGA MEKANIZMI I REFERIMIT, BASHKIA SARANDË	9
TË DHËNA NGA DREJTORIA VENDORE E POLICIË PËR BASHKINË SARANDË	11
TË DHËNA NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR, BASHKIA SARANDË	12
TË DHËNA NGA PROKURORIA E RRETHIT GJYQËSOR, BASHKIA SARANDË	12
REZULTATET E MONITORIMIT – VITI 2020	13
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	13
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	15
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.	20
Konkluzione të rëndësishme	20
Rekomandime kryesore	21

Shkurtime

ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Barazia Gjinore
DhBGj	Dhunë me bazë Gjinore
DhF	Dhunë në Familje
GTN	Grupi Teknik Ndërdisciplinor
INSTAT	Instituti i Statistikave në Shqipëri
KONVENTA CEDAW	Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
KONVENTA E STAMBOLLIT	Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
KD	Komiteti Drejtues
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGj	Nëpunës i Barazisë Gjinore
NjVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
QAGjZh	Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
QZhK "Sot për të Ardhmen"	Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"
REVALB	Sistemi elektronik (on-line) i regjistrimit të rasteve të dhunës në Shqipëri
RrFGSh	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
SKBGj	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
ShGPS	Shoqata e Grave me Probleme Sociale, Durrës
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN WOMEN	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Hyrje

Ky raport u hartua në kuadër të Projektit "Sigurimi i ekspertizës teknike për qeverinë dhe OSHC-të për zhvillimin, buxhetimin, zbatimin dhe monitorimin e masave për adresimin e dhunës ndaj grave në Strategjinë e re për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit", në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave", të financuar nga Qeveria e Suedia i cili po zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA në partneritet me Qeverinë shqiptare. Në Shqipëri projekti u zbatua nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", në bashkëpunim me disa organizata të tjera joqeveritare. Bashkitë e përfshira në monitorim ishin bashkitë e Lezhës, Kamzës, Fierit, Sarandës dhe Pogradecit.

Qëllimi i projektit është monitorimi i i detyrimeve ndërkombëtare dhe kombëtare të Shqipërisë për eliminimin e dhunës ndaj grave dhe të gjitha formave të diskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa rezultati i pritur në terma afatgjatë është ulja e fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe të gjitha formave të tjera të diskriminimit në Shqipëri. Proçesi monitorues i SKBGj dhe PKV 2016-2020 për bashkitë e lartpërmenduar u zhvillua përgjatë periudhës nëntor 2020 - maj 2021. Aktivitetet në nivel qendror u monitoruan nga QAGjZh dhe në nivel lokal nga organizatat lokale, përmes mbledhjes së të dhënave zyrtare lidhur me zbatimin të Qëllimit strategjik 3 të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016 – 2020.¹

Gjatë zbatimit të projektit u arrit që:

1. Të realizohej monitorimi i punës për ti dhënë fund dhunës kundër grave dhe vajzave nëpërmjet mekanizmeve të referimit si një mjet i cili identifikon arritjet dhe sfidat apo boshllëqet ekzistuese.
2. Organizatat partnere në projekt të rrisin kapacitetet për të monitoruar zbatimin e Objektivit të 3-të të Strategjisë Kombëtare dhe Planti të Veprimit për Barazinë Gjinore 2016-2020;
3. U përdorën rezultatet nga monitorimi i fazës së parë për të kontribuar në përpilimin dhe implementimin e Strategjisë së re të Barazisë Gjinore duke filluar nga vitit 2021.
4. U realizua procesi i promovimit dhe advokimit, për zbatimin e objektivit të 3-të të SKBGj 2016-2020, duke përdorur gjetjet dhe rekomandimet e proceseve monitoruese.

Ky projekt, e nisi punën me organizimin e seancave informuese me përfaqësuesit e organizatve partnere në 5 bashkitë nën monitorim, bazuar në udhëzuesin për monitorimin e Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të realizuar nga GADC në Nëntor 2019 dhe të rishikuar në fillim të vitit 2020. Përveç manualit u hartuan skedat monitoruese bazuar në indikatorët për monitorimin e zbatimit të Qëllimit Strategjik 3 të SKBGj 2016-2020, të cilat u përdorën gjatë procesit të monitorimit.

Rreth organizatave zbatuese

Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGjZh) është një organizatë jo-fitimprurëse shqiptare që vepron dhe punon në të gjithë Shqipërinë për fuqizimin e grave dhe për të krijuar një të ardhme të barabartë dhe të drejtë për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta në të gjithë Shqipërinë, duke u përpjekur për t'i nxjerrë nga varfëria dhe përjashtimi. Për të mbrojtur të drejtat e grave dhe për t'i fuqizuar ato, QAGjZh ngre fonde kombëtare dhe ndërkombëtare.

Fushat kryesore të ekspertizës së QAGjZh-së janë:

- Promovimi i paqes dhe përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore;
- Garantimi i fuqizimit ekonomik të grave;
- Sipërmarrjet e grave;
- Fuqizimi i qytetarëve për të monitoruar axhendën gjinore lokale;

¹ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

- Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje;
- Përmirësimi i të drejtave të grave në zona rurale.

Gjatë procesit të monitorimit të bashkive Fier, Lezhë, Pogradec, Sarandë dhe Kamëz QAGJZh bashkëpunoi me disa organizata të tjera të cilat veprojnë në territorin e bashkive nën monitorim si: Qendra Rinore Vlorë, Epoka e Re Fier, Tjetër Vision, Elbasan dhe Shoqata për Integrimin e Zonave Informale Kamëz.

Përse monitorim i SKBGj-së nga OShC-të?

Përgjegjshmëria në qeverisje është një element i rëndësishëm që përcakton marrëdhëniet midis atyre që ushtrojnë fuqinë e pushtetit dhe atyre në emër të të cilëve ushtrohet kjo fuqi. Në sistemet demokratike, fuqizimi i sistemeve të transparencës dhe përgjegjshmërisë është prioritet i vazhdueshëm, që sigurohet përmes mekanizmave të ndërtuar, që përmirësohen vazhdimisht e që garantojnë pjesëmarrjen aktive në vendimmarrjen publike të shoqërisë civile, OShC-ve apo vetë përfaqësuesve të komuniteteve lokale. Këto mekanizma forcojnë proceset demokratike, sigurojnë zhvillim efektiv përmes dhënies së shërbimeve efektive, lehtësojnë procesin e mirëqeverisjes dhe fuqizojnë grupet më vulnerabël të komuniteteve, siç janë vajzat e gratë viktimat të dhunës në familje.

Ndërkohë që ligjet dhe strategjitë kombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e vajzave e grave dhe dhunën në familje/ me bazë gjinore janë hartuar me kontributin e vyer e të pakursyer të OShC-ve të grave, deri tashmë kjo rutinë nuk është shoqëruar me procese monitoruese e vlerësuese nga vetë OShC-të. Organizatat e grave në Shqipëri kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme për të monitoruar dhe vlerësuar strategjitë dhe planet e veprimit në fushën që ato punojnë çdo ditë. Mbi të gjitha, ato për shumë vite kanë luajtur një rol vendimtar në adresimin e dhunës ndaj grave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, rritjes së ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve, lobimit dhe avokimit, duke u bërë kështu aktorë kyç në nivel vendor e kombëtar.

OShC-të janë shumë të interesuara që të monitorojnë strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit, në mënyrë që të ketë një të kuptuar më të mirë të asaj që qeveria po bën në këtë drejtim. Qëllimi përfundimtar është që të zbatojmë një proces monitorimi të paanshëm që do të sigurojë një zbatim më të mirë të hapave të ardhshëm që do ndërmerren për reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në shoqëri. Vlen të theksohet se Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), e ka mirëpritur këtë nismë dhe ka theksuar se ky monitorim nga shoqëria civile do të shërbejë për të informuar edhe procesin e monitorimit të brendshëm të SKBGj 2016-2020 nga institucionet përgjegjëse.

Metodologjia

Për të kryer monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016-2020 dhe Planit të Veprimit u ndoq një qasje e dyfishtë metodologjike në mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Një eksperte lokale u përzgjodh për çdo bashki të targetuar të ngarkuara për të ndjekur punën e bashkisë përkatëse dhe mbledhjen e të dhënave për periudhën Janar – Dhjetor 2020.

Procesi i mbledhjes së të dhënave është kryer si më poshtë vijon:

- Mbledhja e të dhënave përmes takimeve informuese me zyrtarë lokal publik. Faza e parë ishte kontakti me kryetarët e bashkive të targetuara për njoftimin e tyre mbi iniciativën e monitorimit. Më pas monitorueset kontaktuan përmes një formati të njësuar koordinatorin vendor të dhunës pranë bashkisë dhe kurdo që ishte e mundur drejtorinë e shërbimeve sociale, drejtorinë e shëndetit, organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në territorin e bashkisë, zyrtarët e gjykatave të rrethit, komunitetet fetare, mediat, organizatat ndërkombëtare dhe aktorë të tjerë të përfshirë në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Qëllimi i këtyre takimeve ishte vendosja e kontaktit që më pas u ndoq me kërkesa për informacion, të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera mbi punën e kryer nga bashkia dhe institucione të tjera për adresimin e objektivit të tretë të SKBGj për eliminimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Monitorueset

gjithashtu kanë ndjekur takimet e zhvilluara në kuadër të mekanizmit të referimit në bashki dhe kanë raportuar mbi përmbajtjen e tyre dhe vendimet e marra.

- Mbledhja e të dhënave përmes burimeve zyrtare e statistikore. Përmes të drejtës për informim monitorueset kanë kërkuar të gjithë dokumentet mbështetëse të punës së bashkisë në kuadër të luftës kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Specifikisht:
- Janë mbledhur minutat mbi takimet e mekanizmit të referimit për çdo bashki, që kanë plotësuar informacionet e ndara me monitorueset përmes intervistave.
- Janë marrë të dhëna statistikore mbi prevalencën e dhunës në familje nga gjykatat, shërbimi i provës, bashkia, policia, shërbimi social dhe INSTAT.
- Është analizuar buxheti vjetor i bashkisë për të identifikuar burimet financiare të alokuara për zbatimin e SKBGj në luftën kundër dhunës në familje.
- Janë mbledhur materiale mbështetëse për aktivitetet ndërgjegjësuere të zhvilluara nga ana e bashkisë për përmbushjen e objektivit 3.1.

Raporti i monitorimit ndjek strukturën e objektivave specifike të SKBGj sa i përket dhunës me bazë gjinore si edhe aktivitetet specifike të planit të veprimit. Për këtë është hartuar një skedë monitoruese e cila është plotësuar në vijimësi nga monitorueset përmes informacionit të akumuluar përgjatë periudhës monitoruese.

Bazuar tek skeda monitoruese është bërë vlerësim i përmbushjes së angazhimeve të bashkive të targetuara nën objektivin e tretë të SKBGj duke identifikuar nga njëra anë praktikatat pozitive prej të cilave mund të përfitojnë edhe bashki të tjera dhe nga ana tjetër sfidat dhe mangësitë me të cilat përballen bashkitë, për të identifikuar mundësitë për përmirësim në periudhën e mbetur të planit të veprimit të SKBGj.

Për të kryer monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë përdorur edhe të dhënat e sistemit REVALB. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me mbështetjen e UNDP ka hartuar dhe miratuar bazën e nevojshme ligjore për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Bashkërendimit të Punës dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në mënyrë që të parandalohen, raportohen dhe trajtohen me efektivitet rastet e dhunës në familje.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, dt 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” përcakton midis të tjerave dhe detyrimet konkrete të institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Sistemi online në lidhje me statistikatat për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie është lançuar në vitin 2014. Ky sistem online regjistron çdo rast dhune, monitoron si po ecën referimi i rastit dhe ku ka ngecur ai, duke siguruar që t’i shkojë deri në fund çdo rasti të raportuar të dhunës në marrëdhëniet familjare. Sistemi online është i sigurt dhe respekton fshehtësinë e të mbijetuarave të dhunës. Ai përdoret nga një numër i kufizuar i nëpunësve vendorë dhe qendrorë, të cilët janë trajnuar posaçërisht për përgjigjen ndaj dhunës në familje, fshehtësinë e të dhënave të së mbijetuarës dhe për përdorimin e sistemit. Ky sistem aksesohet nga të gjitha bashkitë në nivel lokal dhe MShMS në nivel qendror në adresën www.revalb.org

Mbi bazën e të dhënave të hedhura, sistemi prodhon raporte interaktive dhe të mundshme për t’u printuar në kohë reale të cilat kontribuojnë në: hartimin e politikave; matjen e efektivitetit të Grupeve Teknike Ndërdisciplinore (GTN) të ngritura në nivel lokal; përmirësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal; në marrjen e masave për mirë-funksionimin e mekanizmit referues në të gjitha njësitë vendore; Kryerjen e analizave statistikore, për të identifikuar probleme si dhe fusha ku ka nevojë për ndërhyrje; për të shmangur të gjitha dyshimet për të dhënat e pavërteta ose shifrat e gabuara, që çojnë në rritjen e besimit dhe përmirësimin e shkallës së bashkëpunimit midis aktorëve dhe të atyre që përfitojnë prej saj.

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2020.

Gjetjet kryesore

- Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vitin 2020 janë evidentuar gjithsej 71 raste të dhunës në familje, ku 58 prej tyre ishin gra dhe vajza.
- Përgjatë vitit 2020, Ekipi Teknik Ndërdisciplinar është takuar në 6 mbledhje dhe ka trajtuar 3 raste të dhunës në familje. Komunikimet e tjera dhe menaxhimi i 54 rasteve të tjera është bërë ad-hoc sipas rasteve.
- Sipas informacionit të Gjykatës së Rrethit Sarandë, gjatë vitit 2020 janë rregjistruar 142 kërkesa për Urdhra të Mbrojtjes dhe Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes dhe janë pranuar 119 prej tyre.
- Sipas informacionit nga Koordinatori Vendor pranë Bashkisë Sarandë, vetëm 21 Urdhëra Mbrojtje janë trajtuar me ndihmën ekonomike prej 3000 lekësh të reja si viktimë e dhunës në familje, pasi pjesa tjetër nuk ka qenë e mundur të kontaktohet sepse nuk ka të dhëna kontakti për identifikimin e tyre.
- Të gjitha rastet e pajisura me Urdhër Mbrojtje janë mbështetur me këshillim psiko-social nga shoqata Jona.
- Për vitin 2020 Drejtoria e Shërbimit Social në bashkinë Sarandë, ka funksionuar me 5 punonjës, pasi Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) është shtuar si pozicion më vete në strukturë duke lehtësuar punën e Koordinatorës Vendore, e cila e kryente këtë funksion që nga viti 2019.
- Për vitin 2020 buxheti i bashkisë Sarandë për shërbimet e shpenzuara për viktimën e dhunës në familje nuk parashikonte asnjë zë. Praktikisht janë të parashikuara vetëm pagat e 5 punonjësve të Zyrës së Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Sarandës.
- Koordinatorja Vendore ka ngarkesë për shkak të mbivendosjes së funksioneve, pasi në strukturë ajo është “Specialiste e vlerësimit dhe referimit të rastit dhe punonjëse sociale” dhe kryen edhe funksionet e Koordinatorës kundër dhunës në familje dhe Nëpunëses së barazisë gjinore.
- Numri i pjesëmarrësve në takimet dhe aktivitetet ndërgjegjësuuese ka ndryshuar në varësi të rrethanave për shkak të situatës së pazakontë, krijuar nga pandemia e Covid-19, e cila ka rritur sfidat dhe vështirësuar punën e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) për ndërgjegjësimin e komunitetit në luftën kundër dhunës në familje. Pjesëmarrësit në takimet në vend ose online i përkasin target grupeve të ndryshëm si: nxënës, arsimtarë, psikologë, qytetarë, viktimat e dhunës në familje, gra kryefamiljare, gra me ndihmë ekonomike me fëmijë, gazetarë, punonjëse të institucioneve shtetërore dhe gjimnazistë.
- Në kuadër të dhunës në familje dhe fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”, bashkia Sarandë ka zhvilluar një konkurs online, me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të rrethit Sarandë, nëpërmjet esesë dhe pikturës.
- Bashkia Sarandë në bashkëpunim me shoqatën Jona, ka zhvilluar 4 aktivitete sensibilizuese në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”.
- Zyra Vendore e Shërbimit të Provës Sarandë, është bërë rregullisht pjesë e takimeve të GTN-së edhe pse nuk është pjesë e marrëveshjes. Në kuadër të funksionit të saj, ajo bashkëpunon me institucione si: Gjykata, Prokuroria, Bashkia Sarandë. Për vitin 2020, kjo zyrë ka trajtuar 2 raste, Vënie në Provë Neni 59 i Kodit Penal.
- Zyra e Përmbartimit, gjatë vitit 2020, ka ekzekutuar 63 UM/UMM, ndër to, 4 me objekt “Pension Ushqimor” dhe 10 me objekt “Takim fëmijë” të mbartura. Ndërkohë që kjo zyrë nuk ka trajtuar asnjë rast për çështje me objekt “Urdhër Mbrojtje”.
- Nga rastet e trajtuara nga Mekanizmi i Koordinuar i Referimit, 1 rast viktimë e dhunës në familje dhe e abuzuar seksualisht është trajtuar në qendrën LILIUM, Strehëzën Kombëtare për Viktimat e Dhunës në familje në Kamëz dhe qendrën “VATRA” Vlorë.

- Në prokurori, janë regjistruar dhe proceduar 18 procedime penale, sipas nenit 130/a. Nga këto, tetë raste sipas Nenit 130a/1, një sipas Nenit 130a/2, katër Neni 130a/3 dhe pesë raste sipas nenit 130a/4.
- Zyra Rajonale e Punës ka qenë disi aktive në mbledhjet e ekipit teknik, dhe sipas informacioneve të përfituara ka mundësuar punësimin e grave dhe vajzave përgjatë vitit 2020. Gjatë këtij viti 4 ishin viktimat e dhunës në familje të cilat arritën që të punësoheshin me ndërmjetësimin e kësaj zyre.
- Në bashkinë Sarandë, Organizatat Fetare nuk janë pjesë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe gjithashtu, nuk ka asnjë aktivitet të përbashkët me këtë mekanizëm sa i përket ndëgjegjësimit të komunitetit për të mos pranuar dhunën e asnjë lloji.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Sarandë

Të dhëna nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Sarandë

Gjatë vitit 2020, bashkia Sarandë ka menaxhuar 3 raste në mënyrë ndër-disiplinare ndërkohë që 54 raste janë trajtuar nga ky mekanizëm ad-hoc sipas nevojave. Rastet janë trajtuar dhe ndjekur gjatë 6 mbledhjeve të organizuara, ku 4 mbledhje ishin të thirrura nga Koordinatorja Vendore dhe 2 nga organizata partnere Jona.

Tabela 1. Raste të suksesshme të trajtuara nga Mekanizmi i Referimit, Bashkia Sarandë

Rasti	Trajtimi
Xh.M, e mitur, viktimë e dhunës në familje.	<p>E mitura, XH.M dhunohej nga e jëma. Denoncimi u bë në media nga bashkëjetuesi i mamasë, nëpërmjet rregjistrimeve video dhe audio gjatë abuzimit. Dhuna ishte sistematike por u bë publike më 22.01.2020. Vajza është marë në pyetje në komisariat, në prani të psikologëve, PMF dhe përfaqësues nga Prokuroria.</p> <p>Sipas vlerësimit të riskut, MKR mori vendim, për;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrjen e masave të menjëhershme për sistemimin e vajzes pranë tezes dhe dajos. Me kërkesën e bashkëjetuesit të dergohej edhe djali i tij bashkë me motrën (motër-vëlla nga nëna) tek të afërmit, - Asistim me Këshillim Psikologjik nga shoqata “JONA”, - Monitorim i vazhdueshëm i fëmijës, - Sipas ecurisë së rastit do të shihet për vëmrimë të mëtejshme.
S.B, e mitur, viktime e dhunës në familje dhe e abuzuar seksualisht. UMM 6 muaj.	<p>E mitura, është dhunuar fizikisht nga i jati si edhe ka ngritur akuza për abuzim seksual nga shokët e tij, të cilët janë miq të familjes, të viktimës. Rasti është bërë i ditur nga SPZ e zonës dhe i dashuri i të dhunuarës.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në takimin e parë emergjent të GTN, për vlerësimin e situatës, u morë si masë e menjëhershme sistemimi i

vajzës, në qendrën “LILIUM” në Tiranë.

- Në takimin e dytë, të GTN-së, grupi ishte unanimitisht i mendimit që vajza ishte e vetmja viktimë në këtë skandal mediatik, ku dyshohet për shfrytëzim nga i jati dhe ndodhej në rrezik të lartë. Për këtë arsye, GTN vendosi që vajza në bazë të UMM pas vërtetimit të UMM, për sistemimin në një qendër të specializuar, të vazhdonte përgjatë gjithë kohëzgjatjes së UMM.
- Në takimi e tretë, të GTN-së, u diskutua mbi alternativat dhe menaxhimin e rastit për riintegrimin e viktimës së dhunës.
 - Sipas përfaqësueses të Qendrës Kombëtare të Trajtitimit të Viktimave të Dhunës në Familje, është sugjeruar që vajza të xhvendosej në një qendër tjetër, pasi kjo qendër nuk ka ekspertizën e nevojshme për t’i ofruar mbështetjen psikologjike vajzës në kuadër të abuzimit seksual dhe traumat që ajo mund të shfaqë.
 - Vajza ka marrë shërbim nga psikologjia e qendrës dhe CRCA/ECPAT Shqipëri, onlinë.
 - Në bazë të udhëzimit nga MSHMS, qendra ka punuar me staf të reduktuar dhe kjo e vështirëson ofrimin e një ndihme efikase për vajzën, sidomos për shkak të abuzimit seksual, prandaj shërbimi psiko-social ballë për ballë në një qendër të specializuar ishte tepër i nevojshëm për rasin në fjalë.
 - Mbi këtë sugjerim, të Qendrës Kombëtare, grupi nuk ra dakort, për vet faktin, se një zhvendosje e dytë për vajzën, në një qendër tjetër do të ndikonte negativisht në gjëndjen e saj, psiko-emocionale.
 - Për këtë arsye, u mendua që vajza të vazhdonte trajtimin edhe një muaj në këtë qendër, *(datë 01.07.2020 që përfundon edhe udhëzimi i MSHMS, ku asnjë qendër nuk duhet të ksesohet nga persona të tjerë në kuadër të COVID-19)*, me mbështetje psikologjike të specializuar për dhunën seksuale nga psikologjia e CRCA/ECPAT Shqipëri.
- Në takimin e katërt dhe të fundit që është realizuar për rastin e S.B, është vendosur për transferimin e vajzës tek qendra “VATRA” në Vlorë.
 - Vajzës i është komunikuar ky transferim dhe nuk ka patur kundërshtime prej saj
 - Vajza është lejuar të komunikoj me të dashurin e saj, në monitorim të plotë nga stafi i qendrës.
 - Stafi mendon se ai nuk është shumë i besueshëm.
 - Sipas deklaratës së vajzës të dhënë gjatë seancave me psikologun e BARNAHAUS Shqipëri, përmendur në P.V e mbledhjes së GTN-së, në stafin e qendrës “VATRA” Vlorë, ndodhen dy të afërme të të dashurit, të saj, supozim që u hodh poshtë kategorikisht nga Dretuesja e qendrës “VATRA”.
 - Në rrugë, jo zyrtare, PMF ka informacion se i dashuri i vajzës është arrestuar për dhunë në familje, pasi ka

	<p>ushtruar dhunë ndaj babait të tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> - PMF e bashkisë Sarandë, ka komunikuar me qendrën Vatra për kryerjen e procedurave të transferimit të vajzës. - E cila, firmosi një deklaratë konfirmimi për transferim në qendrën Vatra. - Shoqata “JONA” Sarandë ka ndërlidhur dhe ndihmuar në komunikimin dhe bashkërendimin e punës me qendrën VATRA“ Vlorë. - Shoqërimi i vajzës drejt qendrës “VATRA“ është bërë nga vet qendra, sipas diskutimeve në takimin e GTN-së, ku janë dërguar të gjitha dokumentet zyrtare dhe ndihmëse si vlerësimi psikologjik i vajzës. - Sipas psikologes të BARNAHUS Shqipëri, e cila ka ndjekur vajzën përmes telefonit, adresoi se takimet e vajzës duhet të realizohen vetëm brenda qendrës “VATRA“ të monitorara, pasi Vajza mund të jetë viktimë e mundshme e trafikimit. • Strehimi dhe trajtimi i vajzës, në qendrën “vatra“ vlorë, do të zgjasi deri sa ajo të mbushi moshën 18 vjec.

Burimi: Koordinatorja vendore, bashkia Sarandë

Të dhëna nga Drejtoria Vendore e Policisë për Bashkinë Sarandë

Sipa të dhënave të pëfituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për vitin 2020 pranë Drejtorisë Vendore të kësaj policie, në komisaratin e bashkisë Sarandë u evidentuan 71 raste të dhunës në familje. Nga të gjitha rastet e evidentuara 58 prej tyre ishin gra dhe vajza dhe 45 prej tyre kërkuan Urdhër Paraprak Mbrojtje. Për Veprën Penale neni 130/a² u evidentuan 24 raste ku u arrestuan 4 agresore, 2 u ndaluan dhe 18 agresorë u ndoqën në gjendje të lirë. Në vijim sipas të dhënave të pëfituara nga Drejtoria e Vendore e Policisë pranë bashkisë Saranda, gjatë vitit 2020 pas ndryshimeve të reja në Ligjin “Për masa ndaj dhunës në familje”, 2 ishin rastet kur agresori është nxjerrë nga banesa me ndërhyrjen e policisë.

Tabela 2. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Sarandë

Përshkrimi	Komisariati –Bashkia Sarandë
<p>² Neni 130/a Dhuna në familje Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.</p>	

Evidentuar	71
Të dëmtuar gjithsej	71
Prej tyre gra/vajza	58
KP.U. Mbrojtje	45
Sh.U. Mbrojtjes	1
V. P. Neni 130/a	24
Vrasje raste/viktima	0/0
Arrest. për 130/a	4
Ndaluar për 130/a	2
Gjendje të Lirë për 130/a	18
Në kërkim për 130/a	0
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Sarandë

Përgjatë vitit 2020, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë u paraqitën 142 kërkesa për Urdhër Mbrojtje dhe Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Kjo gjykatë ka pranuar 119 prej tyre, hedhur poshtë 22 kërkesa dhe ka pushuar 1.

Tabela 3. Statistikat e Gjykatës për UM/UMM

Ligji 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithsej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Neni							
Neni 10 pika	62	80	142	119	1	22	1
Totali							

Burimi : Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Sarandë

Të dhëna nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Bashkia Sarandë

Bazuar në të dhënat e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për këtë bashki janë regjistruar 18 raste të veprës penale Dhunë në Familje.

Tabela 4. Statistikat e Prokurorisë Neni 130a/1/2/3/4.

Nr.	Rastet e dhunës në familje	Neni 130a/1	Neni 130a/2	Neni 130a/3	Neni 130a/4
1	Të rregjistruara	8	1	4	5
2	Të proceduara	8	1	4	5
3	Nr I dhunuesve nën hetim	3	0-hetim/ 1 gjykim	4-hetim/4 gjykim	3 -hetim /2gjykim
4	Nr I dhunuesve të arrestuar	2	0	2-arrestuar/ 1 -	3-ndaluar

				ndaluar	
--	--	--	--	---------	--

Burimi: Prokuroria Sarandë

Rezultatet e Monitorimit – Viti 2020

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Gjatë vitit 2020 angazhimi i bashkisë Sarandë për ndërgjegjësimin e shoqërisë ka qenë i niveleve të ulëta, sidomos në periudhën e mbylljes pandemike, ku bashkia u fokusua më shumë në shpërndarjen e pakove ushqimore në ndihmë të grupeve të marginalizuara në përgjithësi dhe viktimave të dhunës në familje në veçanti. 15 ishin gratë dhe vajzat që përfituan nga kjo ndihmë, të gjitha të mbijetuara të dhunës dhe të pajisura me Urdhër Mbrojtje.

Në përgjithësi, punonjësit e Kujdesit Social pranë kësaj bashkie kanë shfrytëzuar rrjetet sociale për ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos pranuar dhunën me bazë gjinore, fushata këto të ndërmarra gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.

Konkretisht, gjatë vitit 2020 janë organizuar vetëm 4 aktivitete ndërgjegjësuese, 3 prej të cilave me iniciativën e bashkisë dhe 1 aktivitet i iniciuar nga organizatat e shoqërisë civile aktive në këtë bashki.

Tabela 5. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr.	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1		Shtëpia e fëmijës “Vangjel Pulla”	“Trafikimi I qenieve njerëzore, stop trafikimit”.	Bashkia Sarandë me shtëpinë e fëmijës “Vangjel Pulla, Sarandë.
2		Shkolla “Adem Sheme” Sarandë	“Trafikimi I qenieve njerëzore”!	Bashkia Sarandë në bashkëpunim me shkollën “Adem Sheme”.
3	08.03.2020	Në pikat e populluara të qytetit	“ NJë lule për ty”!	Shoqata e gruas “JONA” Sarandë, bashkëpunim me gjimnazin “Hasan Tahsini” Sarandë dhe bashkinë Sarandë.
4	10.12.2020	Bashkinë Sarandë	Punimi artistik më I realizuar nga nxënësit në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës.	Bashkia Sarandë, bashkëpunim me shkollën 9-vjecare “9 Tetori” Sarandë.

Burimi: Koordinatorja vendore dhe monitorim I drejtëpërdrejtë, bashkia Sarandë

Në aktivitetin e parë morën pjesë banorët e shtëpisë së fëmijës si edhe mësuesit dhe kujdestarët. Në aktivitetin e dytë, u shpërndanë fletë-palosjeve për “Trafikimin e Qenieve Njerëzore”, ku morën pjesë 65 persona, mes tyre nxënës dhe mësues. Në aktivitetin e tretë, online, të realizuar nga bashkia Sarandë, për fushatën ndërkombëtare të “16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”, target grupet ishin nxënësit ku morën pjesë rreth 116 nxënës me ese dhe piktura.

Ndërkohë që po gjatë vitit 2020 -Shoqata Jona ka realizuar në terren në kuadër të 8-marsit, aktivitetin “Një Lule për Ty”, me pjesëmarrjen e 70 grave dhe vajzave; gjimnaziste, gazetare, punonjëse të institucioneve, gra të dhunuara dhe qytetare të bashkisë Sarandë. Dy aktivitete online me 20 nxënës, mësues dhe psikologë në platformën ZOOM me temë “Rastet e dhunës tek të rinjtë dhe parandalimi” dhe

“Bullizmi dhe influenza e tij, parandalimi i rasteve të dhunës tek të rrinjtë”. Në kuadër të fushatës ndërkombëtare të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.

Gjatë vitit 2020, organizata Jona ka realizuar një trajnim me personelin shëndetësor (60 infermierë dhe mjeke familje) për funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe rolin e tyre si anëtarë.

Në vitin 2020 nuk ka një marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar nga bashkia me Organizatat e Shoqërisë Civile. Ndërkohë që sa i përket trajnimeve të punonjësve të bashkisë përsa i përket dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore, edhe gjatë këtij viti nuk rezulton asnjë trajnim i ndërmarrë nga bashkia. Të vetmet anëtarë të trajnuar janë Koordinatorja Vendore dhe Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve, në një trajnim online nga ASPPA/UNDP/MSHMS me koordinimin e Qendrës shqiptare për popullsi dhe zhvillim me temë “Procedurat Standarte të veprimit për trajtimin e rasteve të dhunës në familje”.

Nuk rezultojnë trajnime të përbashkëta për të gjithë anëtarët e MKR pranë kësaj bashkie, por anëtarë të ndryshëm sipas institucioneve kanë marrë trajnime nga instanca shtetërore apo organizata sipas profilit.

Sipas monitorimit dhe mbledhjes së informacionit përgjatë vitit 2020 janë realizuar disa trajnime nga organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime të cilat janë ndjekur nga anëtarë të ndryshëm të Mekanizmit të Koordinimit pranë kësaj bashkie.

- 02.06.2020 në një trajnim online, të Akademisë së Sigurimit, Tiranë – Pjesëmarrës specialisti për të mitur dhe dhunën në familje.
- Prokuroria e rrethit Gjyqësor Sarandë, ka marrë pjesë në trajnime të vazhdueshme online nga CRCA, UNICEP, OPDAT etj.
- 15.05.2020, Ëebinar për pasojat në marrëdhëniet familjare si rezultat i Covid 19, Gruaja tek Gruaja, Shkoder “Shkëmbim eksperiencash dhe informacioni për dhunën në familje, dhunën në marrëdhëniet intime, ndryshimet në sjelljet njerëzore dhe marrëdhëniet familjare si rezultat i pandemisë së Covid-19.”
- 25.06.2020, Isabel YORDI AGUIRRE – Menaxhere e Programit, Gender and Human Rights, Zyra Rajonale për Europën e OBSH. Moduli 5 “Dhuna seksuale dhe me bazë gjinore gjatë emergjencave humanitare”.
- 30.06.2020 Trajnim; Diskutime dhe marrje informacioni rreth dhunës dhe krimeve seksuale. Si mund të nderhyjnë institucionet dhe si ti njohim këto probleme në brendësi që të mund të ndërhyjmë. Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rinjve nga Dhuna Seksuale, CRCA/ECPAT.
- 6-7.7.2020 Pr. Dr. Arta Mandro; Pr. Dr. Aurela Anastasi, Pr. Dr. Mariana Semini. Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë, UNDP, UN Albania, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- 23.-24.9.2020 - Ndërtimi I Kapaciteteve në Teknologji dhe Aftësi Digjitale, organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim.
- 9.10.2020 – Statistikat Gjinore, organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim.
- 23.10.2020, Parandalimi i Trafikimit të Qënieve Njerëzore në Shqipëri, bashkëbisedim me Sonila Pema, Unicef Albania, Livestream në Facebook.
- 28.10.2020, Procedurat dhe standartet e veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit - Roli i Policisë së Shetit - Bashkëbisedim me Znj. Alma Katragjini - Koordinatorë për Barazinë Gjinore dhe diversitetin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Unicef Albania, Livestream në Facebook.
- 12.11.2020, OPDAT dhe Organizata Terre Des Hommes. Fokus i këtij trajnimi ishte trajtimi i rasteve të trafikimit të qënieve njerëzore.
- 20.11.2020 - Qershor 2021. Çdo të premtë, CRCA/ECPAT Shqipëri dhe BARNAHUS Shqipëri Akademia Multi-Disiplinare të Profesionistëve “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual”.

- 25.11.2020 - Dhuna në familje si fenomen botëror-Michelle Lakomy.
- 02.12. 2020 - Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri. Trajtimi i rasteve të abuzimit seksual në qendrën e manaxhimit të krizave, Liliun.
- 9.12.2020 - Bashkëpunimi Ndërinstitucional për Parandalimin e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore” – OPDAT dhe Prokuroria e Pergjithshme.

Edhe këtë vit, njësoj si një vit më parë, bashkia Sarandë nuk ka vendosur bashkëpunime të mirëfillta me organizata ndërkombëtare sa i përket luftës kundër dhunës me bazë gjinore apo të çfarëdo lloj forme tjetër. Njëjtë, mungon edhe bashkëpunimi apo koordinimi me organizata me bazë fetare për trajnime apo organizim aktiviteteve të përbashkëta. Sipas monitorimit por edhe sipas informacionit të përfituar nga koordinatori vendore, këto organizata nuk pranojnë të jenë pjesë e mekanizmit apo të bashkëpunojnë për fushata të ndryshme. Megjithatë ka kontakte ad – hoc dhe ndërveprim ndërmjet strukturave të ndryshme lokale dhe këtyre organizatave. Shpesh këto organizata ofrojnë shërbime komplementare ndaj atyre që bashkia nuk i ofron dot. Fokusi kryesor i aktiviteteve të tyre është ndërgjegjësimi dhe puna për nxitjen e një familjeje të shëndetshme. Si edhe ndihmat jetike me ushqime dhe veshëmbathje për familjet në nevojë dhe konkretisht viktimat e dhunës në familje që i ka mundësuar nëpërmjet Fondacionit “LIDIA”, i cili i ka munguar gjatë mbledhjeve të mekanizmit gjatë këtij viti, ndryshe nga një vit më parë ku ishte aktive në të gjitha takimet.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Në bashkinë Sarandë Marrëveshja e Bashkëpunimit për ngritjen e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit është lidhur me datë 06.08.2015, në Sarandë, me iniciativën e Shoqatës së Gruas “Jona” Sarandë, Ligji 9669 datë 12.06.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe vendimi nr.334 datë 17.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Gjatë vitit 2020, Bashkia ka trajtuar ad-hoc 54 raste të viktimave të dhunës në familje, ku 21 raste janë mbështetur me ndihmë ekonomike, ndërkohë që viktimat e tjera nuk janë mbështetur sepse nuk është arritur të gjenden adresat e sakta. Ndërkohë në mënyrë të koordinuar i gjithë MKR, në mbledhjet e ekipit teknik ka trajtuar 3 raste, ndër te cilat 2 të suksesshme. Për trajtimin e rasteve është thirrur mbledhje emergjente e të gjithë grupit ku secili përfaqësues ka dhënë kontributin e tij sipas kompetencave.

Koordinatorja vendore pranë kësaj bashkie gjatë vitit 2020 nuk ka ndarë raporte të përmuajshme me anëtarët e mekanizmit të referimit. Informacioni përçohet një herë në tre muaj sipas mbledhjeve apo menaxhimit ad-hoc të rasteve. Ndërkohë që sa i përket sistemit REVALB ai përdoret në mënyrë të rregullt, njëkohësisht edhe me sistemin SHKSH (Sistemi Kombëtar i Shërbimeve Shoqërore) i cili është në fazë eksperimentale dhe sipas koordinatorës përgjatë këtij viti ka shfaqur shpesh problematika teknike. Sistemi REVALB përgjatë vitit 2020 ka shkaktuar problematika që kanë të bëjnë më shumë me shpejtësinë e operimit (shpeshherë mjaft i ngadaltë) dhe sipas informacionit të përfituar nga koordinatori vendore, ka edhe mungesa të indikatorëve të cilët nuk atashohen me formularët fizikë që disponon koordinatori.

Bashkia e Sarandës nuk ka një buxhet të dedikuar për sa i përket shërbimeve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit. Të vetmët zëra që përdoren për MKR janë pagat e punonjësve të kësaj drejtorie.

Janë 27 gra të cilat kanë përfituar bonusin e qerasë për vitin 2020 të alokuar nga Këshilli Bashkiak pranë bashkisë Sarandë, ku 4 prej përfitueseve ishin të mbijetuara të dhunës në familje.

Dega Territoriale e Shërbimit të Provës Sarandë, raporton vetëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës në Tiranë, ndërkohë që pranë Ministrisë së Drejtësisë raportohet vetëm nëse kjo e fundit kërkon informacion, informacion ky i përfutur nga zyra rajonale e këtij shërbimi në Sarandë. Përgjatë vitit 2020, Shërbimi i Provës pranë kësaj bashkie ka trajtuar 2 raste, dhe të dy rastet janë burra me status të divorcuar dhe kallëzimi është bërë për shkak të dhunës ndaj ish-bashkëshortes. Mesatarja e kohëzgjatjes së shërbimit të provës është 2.7 vjet.

Koordinatorja vendore kundër dhunës në bashkinë Sarandë, është znj. Emanuela Cetri. Ajo e mbulon këtë detyrë me kohë të pjeshme pasi ka mbivendosje funksionesh. Në strukturë, pozicioni i saj është "Specialiste e vlerësimit dhe referimit të rastit dhe punonjëse sociale, Koordinatorë kundër dhunës në familje, Nëpunëse e barazisë gjinore. Koordinatorja vendore është nëpunëse me status civil. ZNj. Cetri ka marrë disa trajnime, më së shumti online gjatë vitit 2020, sic cituar në objektivin 3.1.

Sipas informacionit të marrë pranë MKR Sarandë, protokollet e dala nga MSHMS në muajin prill 2020 janë respektuar në mënyrë rigorozë në trajtimin e rasteve, por për shkak të ngarkesës në muajin prill dhe mbivendosjes së funksioneve nuk është bërë e mundur firmosja e këtyre protokolleve nga të gjithë anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.

Bashkia Sarandë, nuk ka buxhet të vecantë për aktivitete ndërgjegjësuese. Fletë-palosjet e përdorura në aktivitetin kundër trafikimit të qenieve njerëzore, janë punuar nga Koordinatorja Vendore dhe printuar në ambjentet e punës. Sipas informacionit të marrë nga Specialisja e Financës, në bashkinë Sarandë, pasqyra e buxhetit për pagat e punonjësve pasqyrohet si vijon:

Tabela 7. Pasqyra financiare e pagave të punonjësve të Kujdesit Social në bashki.

Nr.	Emër	Mbiemër	Pozicioni punës	Paga Bruto	Paga Neto
1	Anila	Pikuli	Drejtor Kujdesi Social	81,000	65,298
2	Emanuela	Çetri	Specialist I vlerësimit të rastit dhe punonjës social	61,640	50,623
3	Vitoria	Vjери	Administartor Shoqëror	58,840	48,501
4	Joana	Arapi	Njësia e mbroj tjes së femijëve	58,000	47,864
5	Manjola	Çelo	Administartor Shoqëror	55,220	45,757
TOTALI				314,700	258,043
TOTALI VJETOR				3,776,400	3,096,516

Burimi: Zyra e financës, Bashkia Sarandë

Bazuar në monitorimin e vitit 2020 por edhe në bazë të informacionit të marrë nga koordinatorja vendore dhe intervistat me anëtarë të ndryshëm të këtij mekanizmi, egziston një frymë bashkëpunuese midis disa institucioneve, veçanërisht midis bashkisë, organizatës Jona, Komisarariatit të policisë Sarandë, Njësia vendore e kujdesit shëndetësor dhe zyraës rajonale të Arsimit. Dokumentat që e vërtetojnë këtë bashkëpunim janë process-verbalet e mbajtura gjatë mbledhjeve të ekipit Teknik ndërdisiplinar, si edhe foto të takimeve dhe të aktiviteteve të përbashkëta.

Sa i përket plotësimit të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, në bazë të ligjit: Plotësimi I UMM dhe UM është detyrë e Komisarariatit, Gjykatës, Prokurorisë përmes padisë publike, çdo avokat, OJF dhe Bashkisë. Por, për vitin 2020 bashkia Sarandë nuk ka plotësuar asnjë UMM apo UM, pasi viktimat shkojnë direkt pranë komisarariatit të policisë.

Gjatë vitit 2020, bashkia Sarandë ka referuar vetëm një rast pranë Strehëzës Kombëtare të Viktimat e Dhunës në familje në Kamëz. Rasti është detajuar në pjesën e parë të raportit dhe është ndjekur nga MKR si edhe nga monitoruesja.

Ekipi Teknik Ndërdisciplinar për vitin 2020 ka organizuar 6 mbledhje por ka patur komunikim të vazhdueshëm ad-hoc online. Ndërkohë që Komiteti Drejtues i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit pranë kësaj bashkie nuk ka organizuar asnjë mbledhje.

Tabela 8. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2020 në Bashkinë Sarandë

Data	Mbledhjet e GTN-së
22.01.2020	<p>Në ambientet e bashkisë Sarandë, në orën 10:00, është zhvilluar mbledhje e GTN-së për ushtrim dhune të nënës ndaj vajzës, së mitur.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja u bë emergjente pasi rasti u bë i ditur nga media. • Në P.verbal nuk pasqyrohet kohëzgjatja e takimit dhe fjala e pjesëmarrësve, por vetëm konkluzionet përfundimtare për zgjidhjen e rastit, • Në takim morën pjesë, 9 persona, përfaqësues të GTN; <ol style="list-style-type: none"> 1. Emanuela Cetri- Koordinatore Vendore 2. Jonana Arapi- PMF 3. Anila Pikuli- Administrator Social, bashkia Sarandë 4. Vitoria Vjeri- Administrator Social, bashkia Sarandë, 5. Entela Gjoni- Përfaqësuese shoqatës së gruas “JONA” Sarandë, 6. Eleni Gërdhuqi- Psikologe pranë shkollës “Adem Shme”, përfaqësuese e Zyrës Arsimore, 7. Brunilda Jaho- Përfaqësuese e Zyrës Arsimore, 8. Iris Hasani- Përfaqësuese e Prokurorisë, 9. Irena Vjeri, Përfaqësuese e organizatës “JOBIS”
22.04.2020	<p>Në ambientet e bashkisë Sarandë, në orën 10:00, nëpërmjet telefonit është zhvilluar mbledhje e GTN-së për ushtrim dhune nga i jati kundrejt vajzës së mitur dhe abuzim seksual nga shokët e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rasti u bë i ditur nga SPZ e zonës dhe i dashuri i vajzës, • Në P.verbal nuk pasqyrohet kohëzgjatja e takimit dhe fjala e pjesëmarrësve, por vetëm konkluzionet përfundimtare për zgjidhjen e rastit, • Në takim morën pjesë, 8 persona, përfaqësues të GTN; <ol style="list-style-type: none"> 1. Emanuela Cetri- Koordinatore Vendore dhe Punonjëse Sociale, 2. Jonan Arapi-PMF, bashkia Sarandë, 3. Anila Pikuli- Administrator Social, bashkia Sarandë, 4. Vitoria Vjeri- Administrator Social, bashkia Sarandë, 5. Entela Gjoni- Përfaqësuese e shoqatës së gruas “JONA “ Sarandë, 6. Eleni Gërdhuqi- Psikologe pranë shkollës “Adem Shme”, përfaqësuese e Zyrës Arsimore 7. Valbona Vasili- Përfaqësuese e organizatës “JOBIS”. 8. Brunilda Jaho- Përfaqësuese e Zyrës Arsimore.
30.04.2020	<p><i>Në bazë të Udhëzimit. Nr. 253, datë 10.4.2020, takimi u zhvillua në orën 13:00 me anëtarët e GTN-së, nëpërmjet telefonit nga PMF në bashkinë Sarandë, për rastin e datës 22.04.2020 (ushtrim dhune dhe abuzim seksual ndaj të miturës).</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Në P. Verbal nuk detaje për diskutimin me c do anëtar por vetëm konkluzionet përfundimtare në efekt të zgjidhjes së rastit,</i> • Në takim morën pjesë, 9 persona, përfaqësues të GTN; <ol style="list-style-type: none"> 1. Jonan Arapi-PMF, bashkia Sarandë, 2. Emanuela Cetri- Koordinatore Vendore dhe Punonjëse Sociale, 3. Anila Pikuli- Administrator Social, bashkia Sarandë, 4. Vitoria Vjeri- Administrator Social, bashkia Sarandë,

	<ol style="list-style-type: none"> 5. Entela Gjoni- Përfaqësuese e shoqatës së gruas “JONA “ Sarandë, 6. Eleni Gërdhuqi- Psikologe pranë shkollës “Adem Shme”, përfaqësuese e Zyrës Arsimore 7. Valbona Vasili- Përfaqësuese e organizatës “JOBIS”. 8. –Brunilda Jaho – Përfaqësuese e Zyrës arsimore, 9. –Iris Hasani- Përfaqësuese e prokurorisë.
03.06.2020	<p><i>Takimi për Menaxhimin e Rastit të së miturës, abuzuar seksualisht nga shokët e babait, është zhvilluar në platformën ZOOM.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Takimi u thirr nga bashkia Sarandë, moderatore Koordinatorja Vendore,</i> • <i>Në p.verbal nuk ka detaje mbi orën dhe minutat e takimit,</i> • <i>Në takim morën pjesë 10 persona, përfaqësues të Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në familje, përfaqësues të CRCA/ECPAT dhe GTN-së;</i> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emanuela Cetri- Koordinatorë Vendore dhe Punonjëse Sociale, 2. Redinela Azizaj- Përgjegjëse e Sektorit Social, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në familje, 3. Klaudio Pulaha- përfaqësues të CRCA/ECPAT 4. Anila Pikuli- Administrator Social, bashkia Sarandë, 5. Entela Gjoni- Përfaqësuese e shoqatës së gruas “JONA “ Sarandë, 6. Joana Arrapi- Punonjëse për Mbrojtjen e fëmijëve në sarandë, 7. Eleni Gërdhuqi- Psikologe pranë shkollës “Adem Shme”, përfaqësuese e Zyrës Arsimore 8. Irena Vjerri- Përfaqësuese e organizatës “JOBIS”. 9. Brunilda Jaho – Përfaqësuese e Zyrës arsimore, 10. Iris Hasani- Përfaqësuese e prokurorisë.
06.07.2020	<p><i>Takimi për Menaxhimin e Rastit të së miturës, abuzuar seksualisht nga shokët e babait, është zhvilluar në platformën ZOOM.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Takimi u thirr nga bashkia Sarandë, moderatore Koordinatorja Vendore,</i> • <i>Në p.verbal nuk ka detaje mbi orën dhe minutat e takimit,</i> • <i>Në takim morën pjesë 12 persona, përfaqësues të Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në familje, përfaqësues të CRCA/ECPAT, përfaqësues të qendrës “VATRA” Vlorë, qendrës LILIUM, “BARNAHUS” Shqipëri dhe GTN-së Sarandë;</i> <ol style="list-style-type: none"> 1. Emanuela Cetri- Koordinatorë Vendore dhe Punonjëse Sociale, 2. Redinela Azizaj- Përgjegjëse e Sektorit Social, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në familje, 3. Klaudio Pulaha- përfaqësues të CRCA/ECPAT, 4. Adena Vangjeli- Avokate, qendra “VATRA”, 5. Erjola Vako- Përfaqësuese e qendrës “LILIUM”, 6. Destemona Cela- Psikologe pranë “BARNAHUS” Shqipëri, 7. Mimoza Sula- Psikologe pranë “BARNAHUS” Shqipëri 8. Joana Arrapi- Punonjëse për Mbrojtjen e fëmijëve në Sarandë, 9. Iris Hasani- Përfaqësuese e Prokurorisë 10. Entela Gjoni- Drejtuese e shoqatës së gruas “JONA “ Sarandë, 11. Eleni Gërdhuqi- Psikologe pranë shkollës “Adem Shme”, përfaqësuese e Zyrës Arsimore 12. Brunilda Jaho- Psikologe, Drejtoria.Arsimore, Sarandë.

Tabela 10. Përbërja e Komitetit Drejtues, Bashkia Sarandë, Viti 2020

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2020
Bashkia	Adrian Gurma
Drejtoria e Policisë	Syrja Bellaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Sokol Pina
Prokuroria e Rrethit	Lorenc Mërkuri
Drejtoria Arsimore Rajonale	Vladimir Demaj
Drejtoria e Shëndetit Publik	Arjan Kalcuni
Drejtoria e Shërbimit Social	Anila Pikuli
Zyra e Përmbarimit	Asaf Stroka
Prefektura	Mirosh Birjani
Zyra e Punësimit	Helidon Onjea
OSHC	Shoqata e Gruas "JONA" Sarandë
Mjeku Ligjor	Hysen Korënica
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor	Arjan Kalcuni
Spitali "Petro Nako"	Erjon Dhroso
Fondacioni "LIDIA"	Ibrahim Bajrami

Burimi: Bashkia Sarandë

Pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në bashkinë Sarandë, pjesë e mbledhjeve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar kanë qene gjithashtu **Shërbimi i Provës dhe organizata "JOBIS"**, të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes së firmosur, por pritet që kryetari i bashkisë të thërrasë Komitetin Drejtues për rifreskim të Marrëveshjes gjate vitit 2021.

Tabela 11. Përbërja e GTN-së, Bashkia Sarandë Viti 2020

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2020V
Bashkia K.V	Emanuela Cetri
Drejtoria e Policisë	Jetnor Pulaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Xhevair Guga

Prokuroria e Rrethit	Iris Hasani
Drejtoria Arsimore Rajonale	Bardhyl Maliqi, Eleni Gërdhuqi, Brunilda Jaho
Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor	Argjentina Alikaj
Zyra e Përmbartimit	Asaf Stroka
Prefektura	Mirosh Birjani
Kryetarët e Njësive Administrative	(Nuk thiren në takime, nuk janë pjesë e MKR)
Zyra e Punësimit	Helidon Onjea
Shoqata e gruas "JONA" Sarandë	Xheni Shehu
Spitali "Petro Nako"	Erjoin Dhroso
Fondacioni "LIDIA"	Ibrahim Bajrami

Burimi: Bashkia Sarandë

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Pranë Zyrës së Përmbartimit ne bashkinë Sarandë gjatë vitit 2020 janë ekzekutuar 63 UM/UMM.

- 48 raste janë ekzekutuar ne zyrë dhe 15 në terren,
- Janë ekzekutuar 4 raste me objekt "Pension Ushqimor",
- Janë ekzekutuar 10 raste me objekt "Takim Fëmije", të mbartura dhe asnjë rast të ri për vendimet e 2020.
- Sipas informacionit të marre nga Zyra e Përmbartimit, gjatë vitit 2020, situata e krijuar për shkak të COVID-19 ka ndikuar ne rritjen e rasteve.
- Zyra e Përmbartimit ka punuar me të njëjtin ritëm edhe gjatë karantinës, ku "Takim Fëmije", UM/UMM dhe "Pension Ushqimor" kanë qenë prioritet.

Problematikat gjatë karantinës kanë qënë në ekzekutimin e rasteve me objekt "Takim Fëmije", për shkak se prindërit kujdestarë nuk pranonin nga frika e infektimit të mundshëm me Covid-19. Situata është menaxhuar me kompromis midis palëve, për takimin e fëmijës gjatë datës së përcaktuar dhe një pjesë pas përfundimit të karantinës. Që prej qershorit, situata shihet e qetë dhe pa problematika duke respektuar Protokollet.

Ndërkohë që në bashkinë Sarandë nuk ka programetë specializuara apo qendra rehabilitimi për dhunuesit.

Konkluzione të rëndësishme

Mekanizmi i Referimit pranë bashkisë Sarandë ka një bashkëpunim shumë të mirë mes disa anëtarësh, veçanërisht me Prokurorinë, shoqatën e gruas Jona, Zyrën Arsimore dhe Komisaratin

por edhe këtë viti anëtarët e tjerë të këtij mekanizmi nuk kanë qenë prezent në mbledhjet e organizuara. Duhet vënë theksi gjithashtu edhe në mungesën e një mbledhje të Komitetit Drejtues për rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit apo për politika të tjera të mirëfunksionimit. Edhe pse një mbledhje e tillë ishte parashikuar për tu organizuar në muajin dhjetor 2020, ajo është shtyrë përsëri për vitin pasardhës.

Numri I rasteve të trajtuara nga MKR pranë kësaj bashkie është shumë herë më i ulët sesa numri I UM/UMM që ka lëshuar gjykata dhe mbi të gjitha, mungon një koordinim bashkëveprues mes institucioneve parësore. Një numër I lartë të iktimave të pajisura me UM nuk kanë përfituar bonusin e asistencës prej 3000 lekësh në muaj sic parashikon ligji, sepse adresat e tyre nuk janë gjendur. Vendimet e plotësuara kanë mungesë të theksuar informacioni, mungesë kjo që vjen si pasojë e neglizhencës së inspektorëve gjatë plotësimit të kërkesave për UM/UMM. Gjykata, institucion thelbësor në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje nuk merr pjesë pothuajse asnjëherë në mbledhjet e ekipit Teknik ndërdisiplinar, ku mund të diskutohet dhe të nxirren analiza të thelluara se pse numri I kërkesave për UM është specifikisht më i lartë sesa UM e lëshuar nga kjo gjykatë.

Megjithëse mbahen process – verbale të mbledhjeve të GTN-së, koordinatorja nuk ndan në mënyrë periodike dhe të përmuajshme raporte të detajuara me anëtarët e këtij mekanizmi, dhe duket sikur ky është një process pune I cili vijon prej kohësh dhe nuk ka iniciativa për ta ndryshuar.

Sipas ndryshimeve të ligjit “9669” datë 18.12.2006 I ndryshuar “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” janë nxjerrë nga banesa 2 dhunues, por problematikë mbetet strehimi I tyre apo edhe rehabilitimi në programme të specializuara duke qenë se pranë kësaj bashkie nuk egzistojnë shërbime të tilla.

Rekomandime kryesore

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Sarandës për vitin 2020, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Sarandë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet rishikim i marrëveshjes së mekanizmit për të bërë pjesë oranzatat që ofrojnë shërbime dhe që kanë shfaqur interes.
- Të rifreskohet lista emërore me kontaktet e detajuara e Ekipit Teknik Ndërdisiplinar sepse nuk ka nje listë konkrete për secilin institucion. Kjo, ndodh, pasi në pjesën më të madhe të këtyre institucioneve, titullarët e tyre, ndryshojnë vazhdimisht. Si rrjedhojë, ata nuk kanë informacion të nevojshem mbi marrëveshjen dhe funksionimin e MKR dhe përfaqësohen nga punonjës të ndryshëm. Prandaj, sugjerohen edhe programe trajnimi për aktorët e Mekanizmit.
- Koordinatorja e MKR-së duhet të ndajë raporte të përmuajshëm apo periodik me anëtarët e MKR-së dhe dokumentat mbështetëse zyrtare.
- Rekomandohet në mënyrë emergjente që Komisariati Sarandë, të marrë masa për rritjen e përgjegjshmërisë së inspektore të zonave, të cilët, plotësojnë kërkesën për UM/UMM, duke i marrë të dhënat për viktimave e dhunës dhe dhunuesit të plota, duke e përshatur formatin tip sipas rastit. Të shihet qartë kërkesa e viktimës (kallzueses) pasi të dhënat nuk korrespondojnë, fakt ky i evidentuar nga gjykata.

- Rekomandohet pjesëmarrje e plotë e të gjithë aktorëve të mekanizmit të referimit në mbledhje apo në aksione të koordinuara midis tyre dhe zhvillimin e mbledhjeve të GTN-se. Veçanërisht institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë; Prefektura; Spitali, Fondacioni Lidia dhe Zyra e Përmbarrimit Sarandë, të cilat, për vitin 2020 nuk janë bërë pjesë e mbledhjeve të GTN-së.
- Duke qënë se pozicioni i Kordinatorës në strukturë ka mbivendosje funksionesh si, “Specialiste e vlerësimit dhe referimit të rastit dhe punonjëse sociale, Kordinatorë kundra dhunës në familje, Nëpunëse e barazisë gjinore”, shpesh herë përgjigjia kundër dhunës me bazë gjinore kalon në plan të dytë. Ndaj rekomandohet rishikimi i strukturës (në emërtesë) dhe stafit, duke i ndarë përgjegjësite, në uljen e ngarkesës të Koordinatorit Vendor, i cili duhe të jetë pozicion më vete.
- Rekomandohet, krahas proces-verbalit të mbledhjeve, të mbahet shënim edhe kohëzgjatja e takimit (minutat), të pranishmit të shënohen jo vetëm me Emer/Mbiemër por edhe pozicioni dhe institucioni, qoftë KD apo GTN-së.
- Koordinatori Vendor të kërkojë nga GTN-ja raporte të rregullta për ç’do rast të evidentuar në institucionin përkatës.
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, të mbahen statistika ose raporte periodike 1-mujore ose 3-mujore, ku të jenë të ndara UMM nga UM, sa janë lëshuar, sa në qytet, sa në fshat, sa të plotësuara nga gjykata, sa të pushuara, sa të rrezuara,sa të pranuara.
- Përsa i përket përqindjes së buxhetit që i dedikohet funksionimit të MKR-së, edhe këtë vit ai i përgjigjet vetëm pagave të stafit, por, duke mos patur të përcaktuar buxhet tjetër si zë të veçantë për aktivitete kundër dhunës, bie efektiviteti i mekanizmit, duke sjellë mos funksionimin e tij, ndaj rekomandohet rishikimi i këtij zëri sidomos për realizmin e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore, për publikimin e fletëpalosjeve ndërgjegjësuese apo materiale të tjera të ngjashme.
- Bashkia të përpilojë një marrëveshje bashkëpunimi me aktorët e mekanizmit (institucionet) për një bashkëpunim sa më të mirë dhe gjithëpërfshirës, si edhe të rishikohet kërkesa për bashkëpunim e organizatave të shoqërisë civile në bashkinë Sarandë.
- Bashkia të zhvillojë takime më të shpeshta me Komitetetin Drejtues pasi jo domosdoshmërisht duhet të zhvillohen aktivitetet në vend, tashmë takimet online janë bërë pjesë e punës së përditshme.